# DËSHMI ARKIVI

**A-463202**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Ia them të vërtetën në sy, edhe pse ai ndonjëherë nuk dëshiron ta dëgjojë”, Melanie Trump flet për bashkëshortin e saj President – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/ia-them-te-verteten-ne-sy-edhe-pse-ai-ndonjehere-nuk-deshiron-ta-degjoje-melanie-trump-flet-per-bashkeshortin-e-saj-president/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:57:37 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 15:41:10 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a142b9bdc83721e327b39e53aaf7d4a3aae9fb965015e6dc204967031008a70b` |
| TEKSTI | `084d6319497567d981a015c2bf691ab47bf70848d6ac3fbacedcc1be81e3e6fb` |
| PAMJA | `bea414406c126e880905a5ac57d79708fd4f822349bbf1c1b02d276536770240` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2b53d176e259fab6dd02f94f5a44a3e187a082ef9c54461d3dd12cc269be66d2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2b53d176e259fab6dd02f94f5a44a3e187a082ef9c54461d3dd12cc269be66d2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

tij të forta.

Zonja Trump e ka përshkruar bashkshortin si një njeri që punon shumë dhe është tërësisht i përqendruar te detyrat e tij si president, duke vlerësuar se ai po bën më të mirën e mundshme gjatë mandatit të tij të dytë.

Në një intervistë për Fox News, zonja Trump ka theksuar se situata është shumë më ndryshe në mandatin e dytë, kjo dhe për shkak të zhvillimetve të forta që po ndodhin ën botë.

"Mendoj se ai po bën më të mirën që mundet", u shpreh Melania Trump.

REKLAMË

Sipas saj, presidenti amerikan punon pa pushim, ka më shumë energji se kushdo tjetër dhe punon pandërprerë nga mëngjesi deri në pasdite.

Moderatori i emisionit, Brian Kilmeade, siç raporton Daily Mail, vuri në dukje se Trump shpesh i kërkon mendimin bashkëshortes së tij pas fjalimeve dhe intervistave. Për këtë arsye, ai e pyeti Melanian edhe për paraqitjen e presidentit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara një ditë më parë, të martën.

"I thashë se bëri një paraqitje të shkëlqyer, se ia doli shumë mirë. Një fjalim i mrekullueshëm", tha ajo.

Melania Trump shtoi se gjithmonë i thotë bashkëshortit të vërtetën.

"I them të vërtetën. Ndonjëherë ai nuk dëshiron të dëgjojë atë që i them,

5 Ndryshime në drejtimin e Policisë së Shtetit, emërime të reja në disa qarqe

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

REKLAMË

por nuk ka problem. Unë gjithmonë them të vërtetën”, theksoi ajo.

Në një moment gjatë fjalimit të tij, teksa fliste për kërcënimet ndaj Iranit dhe deklaratën se do ta asgjësojë, Donald Trump kërkoi në sallë bashkëshorten e tij dhe e vlerësoi publikisht për rolin e saj në sigurimin e kthimit të shumë fëmijëve të zhvendosur nga Ukraina dhe Rusia.

“Ku është zonja jonë e parë? Ku është? Është diku këtu rrotull. A mund ta imagjinoni? Nuk po e shoh zonjën e parë”, tha Trump.

Melania Trump u tha drejtuesve të emisionit se ka komunikim të drejtpërdrejtë me Rusinë dhe Ukrainën dhe se përfaqësuesi i saj po punon për ribashkimin me familjet të edhe më shumë fëmijëve që janë zhvendosur për shkak të luftës.

Duke folur për të ftuarin e Donald Trump, presidentin kinez Xi Jinping, i cili mbërrin sot në Uashington, Melania Trump tha se presidenti kinez vendosi ta bëjë këtë sepse ata kanë marrëdhënie të shkëlqyera dhe ai po vjen në territorin tonë, ndaj duhet ta presim me respektin maksimal.

Ajo do të shoqërojë bashkëshorten e Xi Jinping, Peng Liyuan, në Smithsonian të enjten, përpara darkës zyrtare që do të zhvillohet në mbrëmje.

Dy çiftet pritet të pinë çaj në Shtëpinë e Bardhë të premten, përpara se të vizitojnë së bashku Arkivat Kombëtare.

Melania Trump ishte e ftuar në Fox Neës për të prezantuar edhe Imperia, një samit për lidershipin e grave, të cilin organizatorët e kanë cilësuar si “Davosin për gratë në pozicione drejtuese”.

Gjatë intervistës, ajo paralajmëroi gjithashtu një dokumentar të ri, i cili, sipas saj, do të përmbajë “disa pyetje personale, të cilave do t’u përgjigjem dhe që publiku nuk i ka dëgjuar kurrë më parë”.

“Është më shumë një bisedë personale me mua”, tha Melania Trump për serinë, e cila mund të publikohet në nëntor.

#DonaldTrump #melanietrump #VizionPlus

WRITTEN BY
**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus

Të gjithë artikujt →

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**Rubio: Trump nuk mendon se bota ka...**

Elisjeda Kiko 23 Sht 19:47



BOTA

**Paralajmërimi i fortë i Netanyahut para...**

Elisjeda Kiko 23 Sht 18:31



BOTA

**Goditet grupi mafioz në Itali, arrestohen ...**

Elisjeda Kiko 23 Sht 16:52

REKLAMË



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.